



Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. LEONARD VYRITYT HIDE KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË LIBOHOVË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kryetari i bashkisë.

Z. Leonard Vyrtyt Hide, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë,” si kandidat për kryetar në Bashkinë Libohovë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 31.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik GJR-PS-13983. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Leonard Vyrtyt Hide, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Me vendimin nr. 558, datë 23.05.2023 të KSHZ-së, z. Leonard Vyrtyt Hide, i është dhënë mandati i kryetarit të Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” me anë të shkresës nr. 1297, datë 16.05.2024 informon KQZ-në se, z. Leonard Vyrtyt Hide ka qënë në hetim në vitin 2021, nga Prokuroria Gjirokastër, për çështjen e kanabisit të Qarkut Gjirokastër, në kohën kur ai ushtronte detyrën e Shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjirokastrës. Rezulton se këtë të dhënë, ai nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të depozituar në KQZ.

Gjithashtu me anë të kësaj shkrese, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” informon KQZ-në se për z. Leonard Vyrtyt Hide, SPAK ka përfunduar hetimet dhe e ka dërguar çështjen për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme.. *“pasi dyshohet se në kohën që ka pasur detyrën e Shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjirokastrës, ka lejuar përkundrejt përfitimit kultivimin e bimëve narkotike”*.

Formulari i vetëdeklarimit në pikën III të Dhëna Gjyqësore të Personit, “Pyetjes 3”, “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga ndonjë autoritet i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me jo, pasi pyetja i referohet hetimit apo gjykimit nga autoritetet e huaja dhe jo atyre shqiptare.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1442 prot., datë 30.05.2024, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 739/30, datë 24.09.2024, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Leonard Vyrtyt Hide, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në gjeneralitetet dhe përdorur gjeneralitete të tjera nga ato të deklaruara;
- Nuk rezulton të jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë veprë penale nga autoritete shqiptare ose të huaja gjyqësore;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jo të formës së prerë, nga autoritetet shqiptare ose të huaja gjyqësore, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë dhe jetë në hetim nga:
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenet 248- 25 të Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr.482 të regjistruar më datë 08.11.2023, për të cilën me vendimin penal nr.290/21-2024-55, datë 22.01.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes penale nr. 1132/76010-01377-21-2023 Regj.Themeltar, datë 23.10.2023, që i përket kërkesës “Për dërgimin për gjygj të procedimit penal nr.482 të datës 08.10.2021 me të pandehur BL, Leonard Hide, HM, EL, MD dhe GN” së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, meqënëse i pandehuri Leonard Hide, me vendimin nr.558 datë 23.05.2023 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Libohovë, në Qarkun Gjirokastër, dhe dërgojë çështjen në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO).Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar , me vendimin nr.63 akti të datës 29.03.2024, ka vendosur të “Konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit datë 03.07.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër “Për njoftimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur “ që i përket të pandehurit Leonard Hide, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i Detyrës” kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, dhe ti kthejë aktet që i përkasin procedimit penal nr. 485/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në ngarkim të të pandehurit Leonard Hide, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i Detyrës “kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, Prokurorisë së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të vazhduar hetimet si prokuroria që ka kompetencën lëndore”.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimi i Detyrës”kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr.95 regjistruar më datë 14.05.2024, mbi bazën e vendimit penal nr.63 akti, datë 29.03.2024,

të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ky procedim penal është në fazë hetimi;

- Nuk rezulton të jetë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese sigurimi personal;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar i Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë” “për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Pavlina DOÇAJ	-Shef i Sektorit të Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit
Jona JOSIFI	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Madalena KOJA	-Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 00.2024

Nr: 000

Ora: 0000

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. LEONARD VYRTYT HIDE KRYETAR BASHKIE NË BASHKINË LIBOHOVË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot në datën. 00.10.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Data: 00.00.2024 Nr:1123456
Ora: hm:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar Bashkie në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kryetari i bashkisë.

Z. Leonard Vyrtyt Hide, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë,” si kandidat për kryetar në Bashkinë Libohovë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Për këtë kandidat në datën 31.03.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik GJR-PS-13983. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Leonard Vyrtyt Hide, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Me vendimin nr. 558, datë 23.05.2023 të KSHZ-së, z. Leonard Vyrtyt Hide, i është dhënë mandati i kryetarit të Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

II

Subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” me anë të shkresës nr. 1297, datë 16.05.2024 informon KQZ-në se, z. Leonard Vyrtyt Hide, ka qënë në hetim në vitin 2021, nga Prokuroria Gjyrokastër, për çështjen e kanabisit të Qarkut Gjyrokastër, në kohën kur ai ushtronte detyrën e Shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjyrokastërs. Rezulton se këtë të dhënë, ai nuk e ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit të depozituar në KQZ.

Data: 00.00.2024 Nr:1123456
Ora: hm:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar Bashkie në Bashkinë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë”

Gjithashtu me anë të kësaj shkrese, subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” informon KQZ-në se për z. Leonard Vyrtyt Hide, SPAK ka përfunduar hetimet dhe e ka dërguar çështjen për gjykim pranë Gjykatës së Posaçme.. “*pasi dyshohet se në kohën që ka pasur detyrën e Shefit të Seksionit të Krimeve në Komisaratin e Gjyroskastrës, ka lejuar përkundrejt përfutimit kultivimit e bimëve narkotike*”.

Formulari i vetëdeklarimit në pikën III të Dhëna Gjyqësore të Personit, “Pyetjes 3”, “A keni qënë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga ndonjë autoritet i huaj, për kryerjen e ndonjë vepre penale”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur me jo, pasi pyetja i referohet hetimit apo gjyqimit nga autoritetet e huaja dhe jo atyre shqiptare.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1442 prot., datë 30.05.2024, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 739/30, datë 24.09.2024, Drejtorja e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Leonard Vyrtyt Hide, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në gjeneralitetet dhe përdorur gjeneralitete të tjera nga ato të deklaruara;
- Nuk rezulton të jetë dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë vepre penale nga autoritete shqiptare ose të huaja gjyqësore;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jo të formës së prerë, nga autoritetet shqiptare ose të huaja gjyqësore, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë dhe jetë në hetim nga:
 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyroskastër, për kryerjen në bashkëpunim të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenet 248- 25 të Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr.482 të regjistruar më datë 08.11.2023, për të cilën me vendimin penal nr.290/21-2024-55, datë 22.01.2024, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyroskastër ka vendosur të shpallë moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes penale nr. 1132/76010-01377-21-2023 Regj.Themeltar, datë 23.10.2023, që i përket kërkesës “Për dërgimin për gjyq të procedimit penal nr.482 të datës 08.10.2021 me të pandehur BL, Leonard Hide, HM, EL, MD dhe GN” së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyroskastër, meqënëse i pandehuri Leonard Hide, me vendimin nr.558 datë 23.05.2023 të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve është zgjedhur Kryetar i Bashkisë Libohovë, në Qarkun Gjyroskastër, dhe dërgojë çështjen në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO).Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar , me vendimin nr.63 akti të datës 29.03.2024, ka vendosur të “Konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit datë 03.07.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Gjirokastër “Për njoftimin e akuzës dhe marrjen si të pandehur “ që i përket të pandehurit Leonard Hide, duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i Detyrës” kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, dhe ti kthejë aktet që i përkasin procedimit penal nr. 485/2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër në ngarkim të të pandehurit Leonard Hide, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i Detyrës “kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, Prokurorisë së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të vazhduar hetimet si prokuroria që ka kompetencën lëndore”.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimi i Detyrës” kryer në bashkëpunim e parashikuar nga nenet 248 dhe 25 të Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr.95 regjistruar më datë 14.05.2024, mbi bazën e vendimit penal nr.63 akti, datë 29.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ky procedim penal është në fazë hetimi;
- Nuk rezulton të jetë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat ligjzbatuese për kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Nuk rezulton ti jetë caktuar masë shtrënguese sigurimi personal;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - për qënien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
 - për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë veprë penale prej tij;
 - dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve.

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se subjekti vetëdeklarues z. Leonard Vyrtyt Hide, kryetar i Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë “për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; pikat 12 dhe 13 të kreut V të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S :

1. Z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar i Bashkisë Libohovë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të Kryetarit të Bashkisë.
2. Vazhdimin e mandatit të z. Leonard Vyrtyt Hide, Kryetar i Bashkisë Libohovë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI